



Pranimi / Dorezimi / Prilapsja / Protokoll / Received / Delivered	21. 12. 2020	0 viti / god / year	
Organ / Njësia / Orgj / Unit	Nr / Prot / No / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKRASHCK	3247/2020		118



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHERBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.313/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.273/2019 të datës 13.05.2019, ankesën me numër A.nr.723/2019 të datës 20.11.2019 dhe ankesën A.nr.313/2020 të datës 22.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë fshati "Silovi-Lagja e re", Nr. 24 në Komunën e Lipjanit, të bashkuar në ankesën me numër A.nr.313/2020 të datës 22.10.2020 kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinor", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.313/2020 e datës 22.10.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. NDRYSHOHET Vendimi me Nr. 436 i datës 20.03.2019 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ku nga masa disiplinore "Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet" të shqiptuar ndaj ankuesit ndryshohet me masën disiplinore "Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite".
- III. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 543 i datës 16.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që ti ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerr vendim në pajtim me këtë vendim.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kryeinspektori i Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë më datë 14.02.2019 ka përgatitur raportin për Ministrin e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me inspektimin e pretendimeve të ankuesit [redacted] dhënë në KTV më datë 03.02.2019 me të cilin është konstatuar që ankuesi [redacted] në televizionin KTV më datë 03.02.2019 ka deklaruar se ndaj tij është bërë presion i formave të ndryshme nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, duke përmendur edhe disa shkelje të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së i ka bërë lidhur me krijimin e dy strukturave të paligjshme në Organogramin e SHKK-së, me qëllim të sistemit të njerëzve të tij të besuar me çka është vlerësuar që ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës duke rënë ndesh me dispozitat ligjore në fuqi. I njëjti raport më datë 15.02.2019 është përcjell në Shërbimin Korrektues të Kosovës për procedim të mëtejshëm.

Bazuar në raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, më datë 19.02.2019 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit tek Udhëheqësi i Personelit.

Udhëheqësi i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës më datë 21.02.2019, kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e ka paraqitur në Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 20.03.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 436 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet".

Ankuesi [redacted] kundër Vendimit me Nr. 436 të datës 20.03.2019 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 04.04.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 16.04.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 543 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor dhe duke obliguar zyrën e burimeve njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me Vendimin me Nr. 543 e datës 16.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.05.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 2240/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.05.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 16.05.2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës, faqe 1-46.

Ankuesi [REDAKTUAR], me datë 20.11.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 5454/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kthim në vendin e mëparshëm të punës; mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe transferimi në një vendi tjetër të punës i cili ka qenë i papërshtatshëm për nëpunësin civil, kushtet dhe beneficionet e disfavorshme se sa ato në vendin paraprak të punës si dhe ndikimi negativ në karrierë, mirëpo për shkak që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka qenë funksional nuk është shqyrtuar, ndërsa ankuesit më datë 22.10.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2178/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe mos pagesën e shtesave në pagë dhe kompensimet tjera-shtesa për rrezikshmëri me bazë mujore në vlerën prej 107 Euro.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 13.05.2019 me numër protokollit 2240/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 436 e datës 20.03.2019 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me Nr. 543 e datës 16.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin A.nr.520/2018 dhe A.nr.519/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 11.12.2017 nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Propozim-Vendimi i datës 27.10.2017; E-mailin e datës 07.12.2017, 06.12.2017, 30.08.2017, 31.08.2017, 20.05.2017, 11.12.2017, 11.07.2018, 23.01.2019, 25.01.2019, 27.06.2018 nga ankuesi; E-mailin e datës 10.07.2018, 10.07.2018, 04.07.2018, 02.07.2018 nga [REDAKTUAR]; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 për ankuesin i datës 26.12.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin i datës 27.12.2017; E-mailin e datës 23.01.2019 nga [REDAKTUAR] për ankuesin; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 19.02.2019; Raportin për Ministrin e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me inspektimin e pretendimeve të ankuesit [REDAKTUAR] dhënë në KTV më datë 03.02.2019 i datës 14.02.2019; Inicimin e procedurës disiplinore për Komisionin Disiplinor i datës 21.02.2019; Njoftimin mbi inicimin e procedurës disiplinore për ankuesin datë 21.02.2019; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 25.02.2019; Ankesën e datës 04.04.2019 nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 25.04.2017; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimin me Nr. 567 i datës 19.04.2019; Vendimin me Nr. 568 i datës 19.04.2019; E-mailin e datës 16.05.2019 dhe 23.04.2019 nga [REDAKTUAR]; E-mailin e datës 24.04.2019 nga ankuesi dhe Përgjigjen në ankesë e datës 16.05.2019 me numër protokollit 2322/2019; Ankesën e ankuesit të datës 20.11.2019 me numër protokollit 5454/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 30.10.2019 të ankuesit për Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK; Kërkesën për sigurimin e udhëtimit e datës 28.06.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 01.05.2019 nga Nehat Thaqi për ankuesin; E-mailin e datës 30.04.2019 nga ankuesi për Nehat Thaqi; E-mailin e datës

24.04.2019 nga ankuesi për [REDAKTUAR]; E-mailin e datës 23.04.2019 nga [REDAKTUAR] për ankuesin; Ankesën e ankuesit të datës 22.10.2020 me numër protokolli 2178/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 25.09.2020 nga ankuesi për Ministrin e Ministrisë së Drejtësisë; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 05.04.2017; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosje e datës 03.12.2020; Vendimin me numër VK.nr.21/2020 i datës 03.12.2020; Vendimin me Nr. 2/2020 i datës 14.12.2020 për bashkimin e ankesave të ankuesit; Përgjigjen e datës 15.12.2020 nga [REDAKTUAR]

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional, ndërsa pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shqyrtimit të bazës ligjore, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbledhjen e katërt të mbajtur më datë 09.11.2020 nxjerr Vendim me Nr. 9/2020 me të cilin është vendosur që të gjitha ankesat e dorëzuara dhe ato të kthyera në rishqyrtim nga gjykata do të vendosen nga Këshilli.

Në kuptim të kësaj Kryetari i Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave më datë 03.12.2020 ka parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit për vendosje të ankesës me numër A.nr.313/2020 edhe për dhjetë (10) ditë pune. Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 03.12.2020 ka nxjerr Vendim me numër VK.nr.21/2020 me të cilin ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.313/2020 së ankuesit Ali Gashi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Meqenëse është vendosur që të shqyrtohet edhe ankesat e vitit 2019 atëherë Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.12.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 2/2020 me të cilin ka vendosur që ankesa me numër A.nr.273/2019 e datës 13.05.2019, ankesa më numër A.nr.723/2010 e datës 20.11.2019 dhe ankesa me numër A.nr.313/2020 e datës 22.10.2020 të parashtruara nga ankuesit [REDAKTUAR] të bashkohen në një ankesë për shkak se bazohen në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është pjesërisht e bazuar, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit dhe duke u bazuar në të gjitha provat e lëndës, respektivisht raportin e datës 14.02.2019 të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë i njëjti në televizionin KTV më datë 03.02.2019 ka deklaruar se ndaj tij është bërë presion i formave të ndryshme nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, duke përmendur edhe disa shkelje të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së i ka bërë lidhur me krijimin e dy strukturave të paligjshme në Organogramin e SHKK-së, me qëllim të sistemit të njerëzve të tij të besuar me çka është vlerësuar që ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës duke rënë ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar që ankuesi me deklaratën e tij të dhënë në Televizionin KTV kundër institucionit ku punon dhe kundër menaxhmentit të institucionit ka rënë ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.15 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, nenit 5 paragrafit 5,

nenit 13 paragrafit 1, 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) - NR. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse në bazë të këtyre dispozitave nëpunësi nuk duhet të kryej veprime që bien ndesh me interesat e institucionit pasi që duhet ruajtur besimin e institucionit ku punojnë dhe nuk duhet të bëjnë publike informatat në lidhje me punën e tyre pa autorizim përkatës, kështu që nëpunësit civil gjatë dhënies së deklaratave publike, në asnjë mënyrë nuk u lejohet të japin informata të pasakta dhe mendime personale në lidhje me çështjet në shërbimin civil dhe po ashtu nëpunësit civil çdo kritikë publike ndaj udhëheqësit duhet ta argumentojnë me informata të verifikuara dhe të paraqitura paraprakisht tek udhëheqësi i tyre, mbi këtë bazë çdo nëpunës civil për çdo veprim që bie ndesh me dispozitat ligjor në fuqi do tu nënshtrohen masave disiplinore sipas nenit 63 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëpunësit civilë do t’u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj”*, kështu që nëpunësit janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të shërbimit civil siç përcaktohet me nenin 64 paragrafin 1 Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji”*.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen që ankuesi ka bërë, mirëpo sipas Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit në bazë të Vendimit me Nr. 436 të datës 20.03.2019 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës *“Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet”* është masë e përgjithshme e paraparë me nenin 67 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 pika 1.2.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, sepse nuk është përcaktuar saktë masa e ndalimit të gradimit, pasi që ka qenë obligim të përcaktohet saktë kjo masë, po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit nuk është në proporcion me shkeljen siç përcaktohet me dispozitat e nenit 66 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunësit civil”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se veprimet e ankuesit kanë rënë ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, mirëpo masa disiplinore ndaj ankuesit e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor në bazë të Vendimit me Nr. 436 të datës 20.03.2019 *“Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet”*, është masë e rëndë në krahasim me shkeljen e bërë nga ankuesi, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka të drejtë të ndryshoj masën disiplinore dhe në këtë kuptim masa disiplinore ndaj ankuesit *“Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet”* ndryshohet në masë disiplinore *“Largimi nga Zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues i Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 543 të datës 16.04.2019, nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk janë shqyrtuar drejtë dispozitat ligjore në fuqi të shqiptimit të masës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit në ankesën e datës 20.11.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilat kanë të bëjnë: me kthim në vendin e mëparshëm të punës; mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe transferimi në një vendi tjetër të punës i cili ka qenë i papërshtatshëm për nëpunësin civil, kushtet dhe beneficionet e disfavorshme se sa ato në vendin paraprak të punës si dhe ndikimi negativ në karrierë, ka konstatuar se meqenëse ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës dhe në pajtim me këtë vendim masa disiplinore i është ndryshuar nga ajo *“Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet”* ndryshohet në masë disiplinore *“Largimi nga Zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”*, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se masa disiplinore ndaj ankuesit nuk ka ardhur si iniciativ e institucionit por ka ardhur si shkas i shkeljeve të detyrave të punës së ankuesit, rrjedhimisht kthimi në vendin e tij të punës siç pretendon nuk mund të realizohet pa kaluar afati i transferimit siç është përcaktuar me ndryshimin e masës *“Largimi nga Zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin e ankuesit për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, konstaton se transferimi i ankuesit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan është bërë për shkak të masës disiplinore dhe nuk është bërë si transferim në bazë të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, atëherë kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit bëhet vetëm në rastet kur transferimit bazohet në dispozitat e Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil siç përcaktohet me nenin 5 paragrafin 5 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: *“Nëpunësi civil që transferohet në lokacion tjetër, më larg se pesë (5) km nga vendi aktual i punës së tij, i kompensohen shpenzimet e udhëtimit”*, kështu ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se transferimi në një vendi tjetër të punës i cili ka qenë i papërshtatshëm për nëpunësin civil, kushtet dhe beneficionet e disfavorshme se sa ato në vendin paraprak të punës si dhe ndikimi negativ në karrierë, ka konstatuar që transferimi i ankuesit nuk është bërë si masë disiplinore, në këtë rast duhet respektuar vendimet e ndërmarra që kanë ardhur si pasojë e sjellëve të ankuesit, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara në ankesën e datës 22.10.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të cilat kanë të bëjnë: Mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, Kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe Mos pagesën e shtesave në pagë dhe kompensimet tjera-shtesa për rrezikshmëri me bazë mujore në vlerën prej 107 Euro, ka konstatuar që pretendimet *për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës*, janë shqyrtuar sipas ankesës së datës 20.11.2019 dhe janë elaboruar në paragrafët e paraparak, atëherë lidhur me pretendimin e ankuesit për mos pagesën e shtesave në pagë dhe kompensimet tjera-shtesa për rrezikshmëri me bazë mujore në vlerën prej 107 Euro, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të përgjigjes së datës 15.12.2020 nga z. ██████████ është theksuar që: *“Shtesa prej 107 euro epet për zyrtarët korrektues të cilët janë të uniformuar, Drejtoreve dhe Zëvendës Drejtoreve të Institucioneve Korrektuese, Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorët si dhe Drejtori për siguri, të gjithë këta në mënyrë të drejtpërdrejt apo përmes vendimeve të nxjerrura i ekspozohen rrezikut. Pjesa tjetër e stafit që puna e tyre nuk ndërlidhet me sigurinë si: Drejtor e Departamenteve dhe Udhëheqëset e divizioneve dhe stafi profesionale marrin shtesa për rrezikshmëri në punë prej 35 Euro, pasi që nuk i ekspozohen drejtpërdrejt rrezikut”,* rrjedhimisht në bazë të kësaj përgjigje ankuesi nuk mban asnjëherë nga pozitat si në përgjigje atëherë nuk ka mund të realizoj ku shtesën në pagë prej 107 Euro, kësaj nuk ka mund të realizoj këtë pretendim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e shqyrtuar të gjitha provat e lëndës bazën juridike dhe meqenëse masa disiplinore në bazë të këtij vendimi ndaj ankuesit është ndryshuar nga masa disiplinore *“Largimi nga Zyra dhe Transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet”* në masë disiplinore *“Largimi nga Zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”,* atëherë Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në pajtim me këtë vendim është i obliguar që të nxjerr vendim për transferim të ankuesit për periudhë *për dy (2) vite* nga dita e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 436 të datës 20.03.2019 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa pas kalimit të periudhës së masë disiplinore *“Largimi nga Zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit për dy (2) vite”,* ankuesi kthehet në vendin e tij të punës në pozitën *“Drejtor i Drejtoratit për Trajnim të Burgosurve dhe të Miturve në Drejtorinë Qendrore”* sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit të datës 05.04.2017, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj nëse ndonjëra nga palët që ka mundur të hap konflikt administrativ si pasojë e mos veprimit të KPMSHCK-së duhet të veproj konform dispozitës së shënuar më poshtë të Ligjit për Konfliktin Administrativ i cili përcakton si vijon: Neni 36 1. Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftojë edhe gjykatën. 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia; 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. 8 3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2. i këtij neni, gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës. 4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.313/2020; datë 21.12.2020

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit ██████████
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.